

## **NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit A. R., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.1687/15 të datës 26.05.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren Musli Gashi, të dëmtuarit Safet Shala, me datë 30.12.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **Ndaj të akuzuarit**

**A. R.**, nga i ati R. dhe nëna N. e lindur A., i lindur me datë *data e lindjes...*, në fshatin B., Komuna e D., tani jeton në P., rruga ..., ..., ka të kryer shkollën e mesme, farmacist, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPP-ës.

### **REFUZHET AKUZA**

Se me datën 06.09.2014, rreth orës 18,50 minuta, në Prizren, në rrugën ..., në afërsi të shkollës së mesme teknike, seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë se do ta privoj nga jeta ose do t'i shkaktoj lëndim të rëndë trupor, në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje në mes të pandehurit dhe të dëmtuarit S. Sh., në lidhje me motrën e të dëmtuarit, i pandehuri me një shkrepës – imitim i armës së zjarrit e kanos të dëmtuarin me fjalët “të vras”, me ç’ rast tek i dëmtuari shkakton frikë dhe ankth,

Këso dore do të kishte kryer veprën penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-së.

Pasi që prokurori i shtetit në shqyrtimin gjyqësor me datë 30.12.2016, është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale kundër të akuzuarit A. R., nga P., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës, pasi që paraprakisht i dëmtuari S. Sh., deklaroi që si palë e dëmtuar nuk është interesuar për ndjekjen e mëtutjeshme penale të akuzuarit në këtë çështje penale, e duke pasur parasysh që procedura penale për këtë lloj të veprës penale fillon me propozimin konform nenit 185 par.5 të KP-ës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr 1687/2015 të datës 26.05.2016, kundër të akuzuarit A. R., nga P., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës,

Në shqyrtimin gjyqësor me datë 30.12.2016 prokurori i shtetit Musli Gashi, është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale, ndaj të akuzuarit A. R., për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 185 par.2 të KP-ës, pasi që paraprakisht i dëmtuari S. Sh., në shqyrtimin gjyqësor është tërhequr nga ndjekja e mëtutjeshme penale në këtë çështje juridike, e duke pasur parasysh që procedura penale për këtë llojë të veprës penale fillohet sipas propozimit, komform neni 185 par.5 të KP-ës,

Andaj nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform neni 363 par.1 pika 1.1 të KPP-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e bazoi konform neni 450 dhe 451 të KPP-ës.

### **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN P.nr.1103/2016 me datë 30.12.2016**

**Procesmbajtesja  
Naxhis Sharani**

**Gjyqtari,  
Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakenaqr ka te drejtë ankese në afat prej 15 ditesh nga dita e marrjes se njejtës, Gjykates se Apelit ne Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.